

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni për Çështje civile me gjyqtaren Hunaida Pasuli, në çështjen juridiko-civile të paditëses R.A., e punësuar si asistente në arkën kryesore Njësia “V.” P.1 P.2, kundër të paditurës P. dhe T. i K (PTK) sh a P., tani T.i K., lidhur me kërkesëpadinë për kompensimin e diferencës së pagës, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur më datë 04.04.2017, në të cilin të pranishëm ishin paditësja R.A. dhe përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës H.I., më 28.04.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses R.A. nga P.2

DETYROHET pala e paditur ish P.1 tani T. i K. sh a P.2 qënë afatin kohor prej 15 ditëve nga pranimi i aktgjykimit paditëses për periudhën kohore 01.02.2012 deri më 31.08.2013 t’ia kompensoj diferencën në pagë, kontributetpensionale dhe tatimit në pagë në mes të gradës 4 dhe 5,në shumën e parave të specifikuar si në vazhdim:

Në emër të diferencës në pagën neto shumën e parave prej 1,260.58€

Në emër të kontributit pensional shumën e parave prej 73.72€ dhe

Në emër të tatimit në pagë në dobi të Buxhetit të Kosovës shumën prej 140.06€,-
Në emër të kamatës në shumën e parave prej 373.99€,të llogaritur nga data 01.02.2012 deri më31.08.2013

II. DETYROHET pala e paditur që në afatin kohor prej 15 dite tëkompenzoj shpenzimet e procedurës nëshumë150€

Arsyet i m

Paditësja R.A. nga P.2 përmes padisë së parashtruar më03.05.2012 ka kërkuar anulimin e vendimit të P.1 me numër 01-1040-825, datë 07.03.2012për caktimin e lartësisë së të ardhurave personale. Gjithashtu përmes padisë ka kërkuar edhe kompensimin e diferencës së pagave në mes të gradës 5 dhe 4, nga data 01.02.2012 (si datë e hyrjes në fuqi të vendimit kontestues) e deri mëdatë 31.08.2013

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin C.nr.1020/2012, datë 16.05.2013, e ka miratuar kërkesëpadinë e paditëses. Duke vepruar sipas ankesës të palës së paditur, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin Ac.nr.3505/13, datë 12.01.2016, e ka pranuar si të bazuar ankesën përkitazi me pjesën e kërkesëpadisë për pagesën e ndryshimit të pagës në mes të gradës 5 dhe 4 dhelëndën në këtë pjesë e ka kthyer në rigjykim. Ndërsa aktgjykimi në fjalë është vërtetuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës (Rev.nr.305/2016 të dt.14.11.2016).

Në seancën e datës 07.02.2017 në rigjykim paditësi ka deklaruar se mbetet në tërësi si në padi dhe në seancat e mbajtura. Mbi bazën e ekspertizës financiare ka precizuar lartësinë e kërkesëpadisë dhe ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të ndryshimit në pagë nga data 01.02.2012 (si datë e hyrjes në fuqi të vendimit të kundërligjshëm për caktimin e lartësisë së të ardhurave personale) deri më datën 31.08.2013 (pasi nga data 01.09.2013 i është rikthyer paga sipas gradës 5), t'i paguhet paga neto në shumën prej 1,260.58€, kontributi pensional prej 73.72€ që duhet paguar në llogarinë e paditëses në Trustin e kursimeve pensionale të Kosovës dhe tatimi në pagë në dobi të Buxhetit të Kosovës shumën prej 140.06€, si dhe kamatën në shumën e parave prej 373.99€.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: për ekspeditën financiare shumën prej 120€ si dhe për taksa gjyqësore për padi dhe aktgjykim.

E paditura në përgjigjen në padi dhe në seancat gjyqësore në rigjykim e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses me arsyetimin se vendimi për caktimin e lartësisë së pagës është bazuar në autorizimet e Kryeshefit ekzekutiv të palës së paditur si dhe në rekomandimin e Ministrisë për Zhvillimin Ekonomik për reduktimin e shpenzimeve të P. për 20%. Gjithashtu e paditura ka parashtruar vërejtje në drejtim të ekspertizës financiare, duke theksuar se ekspertiza është joprofessionale e paqëndrueshme, e pasaktë, në kundërshtim me dispozitat ligjore. Nga arsyet e theksuara në përgjigjen në padi, në ankesën kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe në arsyet e paraqitura në revizion ka propozuar që kërkesëpadia të refuzohet e pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Në procedurën e provave në rigjykim, me pajtimin e palëve ndërgjyqësore është lexuar procesverbali nga seanca e shqyrtimit kryesor në lëndën C.nr.1020/12, datë 16.05.2013 në të cilën janë administruar provat propozuara nga palët ndërgjyqësore, ndërsa si provë e re është lexuar ekspertiza financiare e datës 21.02.2017, e hartuar nga ekspertja gjyqësore M.M.

Nga deklaratimet e palëve ndërgjyqësore në riprocedurë ka rezultuar se për të paditurën kontestuese është sikurse baza juridike e kërkesëpadisë ashtu edhe lartësia e kërkesëpadisë.

Gjykata duke iu referuar pretendimeve të palës së paditur të parashtruar në rigjykim, vlerëson se kontestimi i bazës juridike të kërkesëpadisë është i paqëndrueshëm nga fakti se sipas aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3505/13, datë 12.01.2016 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.305/2016, datë 14.11.2016, çështja e paditëses është kthyer në rigjykim vetëm sa i përket detyrimit të të paditurës për pagesën e ndryshimit të pagës, bonusit dhe trustit, meqë në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nuk është përcaktuar lartësia e pagesës e shprehur në para.

Duke marrë parasysh se kundërligjshmëria e vendimit të të paditurës me të cilin paditëses i është zvogëluar paga nga grada 5 në 4 është vërtetuar me aktgjykim të formës së prerë dhe duke marrë parasysh se paditësja, nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të kundërligjshëm 01.02.2012, e deri në lidhjen e kontratës së re, datë 31.08.2013, ka pësuar dëm material në lartësinë e llogaritur si në ekspertizën e plotësuar financiare, prandaj në mbështetje të ekspertizës të cilës gjykata ia fali besimin në tërësi, është vendosur për detyrimin e të paditurës që paditëses t'i akompensoj ndryshimin në pagë, kontributet pensionale dhe tatimin në pagë, bashkë me kamatën e llogaritur nga data 01.02.2012 e deri në hartimin e ekspertizës, në shumën e parave të përshkruar si në paragrafin I të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet e palës së paditur se ekspertiza financiare është e pasaktë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, mirëpo këto i vlerësoi si të pambështetura, pasi ekspertiza është punuar në kuptim të detyrave të caktuara nga gjykata, ndërsa llogaritja e diferencës në pagë është mbështetur kryesisht në të dhënat e siguruar nga pala e paditur nga të cilat është vërtetuar lartësia e pagës së realizuar nga grada 5 si dhe lartësia e pagës nga grada 4, respektivisht dëmi material të cilin e ka pësuar paditësja si pasojë e vendimit të kundërligjshëm nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, e deri në ndryshimin e rrethanave me lidhjen e kontratës tjetër të punës. Ndërkaq duke marrë parasysh se për palën e paditur kontestuese është baza juridike e kërkesëpadisë, për këtë arsye gjykata ka mbajtur seancën kryesore në mungesë të ekspertit financiar pasi ka vlerësuar se vërejtjet e të paditurës janë jo esenciale dhe shtyrja e seancës do të kontribuonte zvarritjes së panevojshme të procedurës në këtë çështje kontestimore.

Nga arsyet e theksuara dhe në pajtim me nenin 55 të Ligjit për punë lidhur me nenin 277 të LMD – së (gjykata vendosi si në paragrafin nën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 449, 452 par 1 dhe 453 të Ligjit për procedurën kontestimore. Lartësia e shpenzimeve i referohet shumës prej 120€ për ekspertizë financiare, 15€ për taksën gjyqësore për padi dhe 15€ në emër të taksës për aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
C.nr.2994/16 datë 28.04.2017

Gjyqtarja

Hunaida Pasuli

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa dorëzohet përmes gjykatës themelore në Prishtinë.